NUMRI I HUASË 9160-AL

Marrëveshje Huaje

(Projekti për Reagimin ndaj Emergjencës COVID-19 në Shqipëri)

ndërmjet

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

dhe

BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

MARRËVESHJE HUAJE

MARRËVESHJA fillon nga Data e Nënshkrimit ndërmjet REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ("Huamarrësi") dhe BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM ("Banka"). Me anë të kësaj Marrëveshjeje Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

NENI I — KUSHTET E PËRGJITHSHME; PËRKUFIZIMET

1.01. Kushtet e Përgjithshme (siç përcaktohet në Aneksin e kësaj Marrëveshjeje) janë të zbatueshme për këtë Marrëveshje dhe janë pjesë e saj.

1.02. Në rast se nuk kërkohet ndryshe në kontekst, termat me gërma kapitale që përdoren në këtë Marrëveshje, kanë kuptimet që iu jepen në Kushtet e Përgjithshme apo në Aneksin e kësaj Marrëveshjeje.

NENI II — HUAJA

2.01. Banka bie dakord t'i japë Huamarrësit një hua në shumën prej pesëmbëdhjetë milionë Euro (€ 15.000.000), shumë që herë pas here mund të konvertohet përmes Këmbimit Valutor ("Huaja"), për të asistuar në financimin e Projektit që përshkruhet në Skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje ("Projekti").

2.02. Huamarrësi mund t'i tërheqë të ardhurat nga Huaja në përputhje me Seksionin III të Skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03. Tarifa Fillestare është një e katërta e një për qind (0.25%) të shumës së Huasë.

2.04. Komisioni i Angazhimit është një e katërta e një për qind (0.25%) në vit për Balancën e Patërhequr të Huasë, me kusht që Komisioni i Angazhimit për periudhën që fillon në datën e grumbullimit të Komisionit të Angazhimit dhe që përfundon në datën e përvjetorit të parë të kësaj date të grumbullimit, të jetë zero për qind (0%).

2.05. Norma e interesit është Norma e Referimit plus Shprëndarje Fikse apo normën që mund të jetë e zbatueshme pas një Konvertimi, sipas Seksionit 3.02(e) të Kushteve të Përgjithshme.

[2.06]. Datat e Pagesës janë datat 1 Maj dhe 1 Nëntor të çdo viti.

[2.07.] Shuma e principalit të Huasë shlyhet në përputhje me Skedulin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

NENI III — PROJEKTI

3.01. Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit dhe Programit MPA. Për këtë qëllim, Huamarrësi zbaton Projektin, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përputhje me dispozitat e Nenit V të Kushteve të Përgjithshme dhe Skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

NENI IV — HYRJA NË FUQI; ZGJIDHJA

4.01. Afati i hyrjes në fuqi është njëqind e njëzetë ditë (120) ditë pas Datës së Nënshkrimit.

NENI V — PËRFAQËSUESI; ADRESAT

5.01. Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i tij i Financave.

5.02. Për qëllime të Seksionit 10.01 të Kushteve të Përgjithshme: (a) adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.3
Tiranë, Shqipëri; dhe

(b) adresa elektronike e Huamarrësit është:

E- mail:
sekretariamin@financa.gov.al

5.03. Për qëllime të Seksionit 10.01 të Kushteve të Përgjithshme: (a) adresa e Bankës është:

International Bank for Reconstruction and Development
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America; dhe

(b) adresa elektronike e Bankës është:

Teleks:	Faks:	E-mail:
248423(MCI) ose 64145(MCI)	1-202-477-6391	msalim1@worldbank.org

ËSHTË RËNË DAKORD që nga Data e Nënshkrimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga Nënshkrimi

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: ANILA DENAJ

Titulli: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Data: 15 tetor 2020

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga Nënshkrimi

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: MARYAM SALIM

Titulli: Menaxher vendi

Data: 15 tetor 2020

SKEDULI 1

Përshkrimi i Projektit

Objektivat e Projektit synojnë parandalimin, zbulimin dhe reagimin ndaj rrezikut që paraqet COVID-19, si dhe fuqizimin e sistemeve kombëtare të gatishmërisë së shëndetit publik në Republikën e Shqipërisë.

Projekti është një fazë e Programit MPA dhe konsiston në pjesët si më poshtë:

Pjesa 1. Mbështetje sektorit shëndetësor për të reaguar ndaj COVID-19 menjëherë dhe në një periudhë afatmesme

1.1 Fuqizmi i funksioneve kryesore të shëndetit publik për parandalimin e përhapjes së COVID-19, ndër të tjera, përmes: (a) fuqizimit të rrjetit të survejancës epidemiologjike, ndër të tjera, të sëmundjeve që paraqesin ngjashmëri me gripin, duke përfshirë sistemet e njoftimit të hershëm lidhur me rishfaqjen e përhapjes së vazhdueshme në komunitet; (b) fuqizimit të laboratorëve kombëtarë të referencës dhe shëndetit publik, si dhe të kapaciteteve epidemiologjike për zbulimin dhe konfirmimin në një fazë të hershme të rasteve të COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera që lidhen me të; (c) mbështetjes së zbulimit të rasteve të reja dhe gjurmimit të kontakteve aktive, duke përfshirë, ndër të tjera, sipas rastit, rekrutimin e personelit të ri dhe blerjen e pajisjeve (automjete për transportimin e të sëmurëve, kompjutera dhe tabletë) dhe të një programi kompjuterik të bazuar në aplikacione ose faqe interneti për dokumentimin dhe komunikimin; (d) mbështetjes për trajnimin dhe edukimin e shërbimit epidemiologjik dhe hetimin epidemiologjik; (e) fuqizimit të vlerësimit të riskut epidemiologjik dhe vendimmarrjes; (f) sigurimit në kohë të të dhënave dhe informacioneve për orientimin e vendimmarrjes dhe të veprimtarive reaguese dhe zbutëse; dhe (g) fuqizimit të HMIS-së për mundësimin e rregjistrimit dhe shpërndarjes virtuale në kohë të informacionit.

1.2 Fuqizimi i sistemit shëndetësor për rritjen e kapaciteteve për trajtimin e rasteve të COVID-19 dhe sëmundjeve, që lidhen me të, ndër të tjera, përmes: (a) kryerjes së punëve të vogla civile (brenda gjurmës fizike ekzistuese) në SHSIQSUNT për përmirësimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës; (b) rehabilitimit të SHSIQSUNT-së, ndër të tjera, për rritjen e numrit të shtretërve në reanimacion dhe instalimin e pajisjeve shëndetësore të nevojshme; (c) sigurimit të pajisjeve dhe materialeve të tjera të rëndësishme shëndetësore, duke përfshirë kitet diagnostikuese për koronavirusin; (d) sigurimit në shkallë të gjerë të pajisjeve mbrojtëse personale për punonjësit e kujdesit shëndetësor; (e) sigurimit të trajnimit dhe udhëzuesve të përshtatur për punonjësit e kujdesit shëndetësor për identifikimin dhe trajtimin e COVID-19, për përdorimin siç duhet të pajisjeve mbrojtëse personale, si dhe për mbikëqyrjen e sëmundjes dhe parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore brenda strukturave të kujdesit shëndetësor; (f) blerjes së ambulancave moderne ose automjeteve për transportimin e të sëmurëve, me qëllim dërgimin e personave të infektuar në vendet e posaçme për trajtim; dhe (g) mobilizimit të profesionistëve të kualifikuar në fushën e shëndetit, të cilët aktualisht nuk punojnë në sistemin publik të kujdesit

shëndetësor, dhe të studentëve të vitit të fundit të mjekësisë, me qëllim ofrimin e shërbimeve klinike për t'iu përgjigjur pandemisë.

1.3 Mbështetje për masat e distancimit fizik dhe komunikimin në distancë, ndër të tjera, përmes: (i) sigurimit të distancimit të sigurt fizik, duke përfshirë në rastin kur është e zbatueshme për përgjegjësitë e Huamarrësit dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe shoqëror; (ii) zhvillimit të aftësive të fuqisë punëtore dhe kapaciteteve teknologjike, me qëllim mundësimin më lehtësisht të konsultave mjekësore në distancë nëpërmjet teknologjisë së telekomunikacionit (telemjekësisë) dhe që shërbimet, të cilat nuk mund të zëvendësohen nga platformat virtuale, të mund të ofrohen praktikisht në kushtet e masave të marra për distancimin fizik; (iii) krijimit dhe shpërndarjes së materialeve në media të llojeve të ndryshme (duke përfshirë median e bazuar në faqet e internetit, median e shkruar dhe videot) që japin shpjegime lidhur me procesin dhe arsyetimin për rihapjen; dhe (iv) hartimit të udhëzuesve për masat lidhur me distancimin fizik, të përshtatur sipas sektorëve ose grupeve specifike dhe të përshtatura, sipas nevojës, për fazat e rihapjes nga epidemia përmes medias së shkruar dhe jo të shkruar dhe në gjuhët që përdoren në komunitet, duke përfshirë, ndër të tjera udhëzuesit për: (a) lloje të ndryshme biznesi; (b) udhëtarë; dhe (c) shërbime të kujdesit shoqëror në bazë komuniteti, rezidenciale dhe të specializuara, të tilla si ato që lidhen me fëmijët, dhunën për shkak të gjinisë dhe trafikimin e komuniteteve rome dhe egjiptiane.

Pjesa 2. Menaxhimi i Projektit

Kryerja e veprimtarive për menaxhimin e Projektit,duke përfshirë: (a) përmbushjen e kërkesave për menaxhimin financiar dhe prokurimin, si dhe të kushteve mjedisore dhe sociale të Projektit; (b) monitorimin dhe vlerësimin e Projektit; dhe (c) rekrutimin e personelit/ konsulentëve shtesë të ngarkuar me administrimin e përgjithshëm, prokurimin dhe menaxhimin financiar.

SKEDULI 2
Zbatimi i Projektit

Seksioni I. Masat e zbatimit

A. Masat institucionale

Për lehtësimin e zbatimit të Projektit, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ngre dhe drejton, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, një Njësi për Koordinimin e Projektit (NJKP) me funksione, personel dhe përgjegjësi të pranueshme për Bankën, siç përcaktohet në Manualin Operacional të Projektit.

B. Manuali Operacional i Projektit

1 Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas Datës së Hyrjes në Fuqi, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, miraton dhe më tej, zbaton Projektin në përputhje me një manual (Manualin Operacional të Projektit), të pranueshëm për Bankën, i cili ndër të tjera, përmban: (i) dispozita të veçanta për procedura të hollësishme lidhur me zbatimin Projektit; (ii) përbërjen dhe përgjegjësitë e NJKP-së; (iii) kërkesat për prokurimin, menaxhimin financiar dhe disbursimin lidhur me to; (iv) kërkesat për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave personale në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare; (v) treguesit e performancës; dhe (vi) Udhëzuesin Anti-korrupsion.

2. Huamarrësi nuk amendon, nuk heq dorë apo nuk mund të mos zbatojë ndonjë dispozitë të Manualit Operacional të Projektit pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës. Në rast konflikti midis termave të Manualit Operacional të Projektit dhe atyre të kësaj Marrëveshjeje, do të mbizotërojnë termat e kësaj Marrëveshjeje.

D. Standardet Mjedisore dhe Sociale

1. Huamarrësi garanton se Projekti do të zbatohet në përputhje me Standardet Mjedisore dhe Sociale, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

2. Pa kufizim ndaj paragrafit 1 të mësipërm, Huamarrësi garanton se Projekti do të zbatohet në përputhje me Planin për Angazhimin Mjedisor dhe Social (PAMS), në një mënyrë të pranueshme për Bankën. Për këtë qëllim, Huamarrësi garanton se:

(a) masat dhe veprimet e specifikuara në PAMS do të zbatohen me kujdesin e duhur dhe efektivitet, dhe do të jenë pjesë e PAMS-së;

(b) do të vihen në dispozicion fonde të mjaftueshme për mbulimin e kostove për zbatimin e PAMS-së;

(c) do të ndiqen politika dhe procedura, dhe për zbatimin e PAMS-së, do të ruhet numri i mjaftueshëm i personelit të kualifikuar dhe me përvojë, siç parashikohet në PAMS; dhe

(d) PAMS apo ndonjë dispozitë e tij nuk do të amendohet, shfuqizohet, pezullohet apo shmanget, përveç kur Banka bie dakord ndryshe me shkrim, siç përcaktohet në PAMS, dhe garanton se PAMS-i i rishikuar do të njoftohet menjëherë në vijim.

3. Në rast mospajtimi midis PAMS-së dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

4. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,garanton se:

(a) do të merren të gjitha masat e nevojshme për grumbullimin, përpilimin dhe dhënien për Bankën, përmes raporteve të rregullta, me shpeshtësinë e caktuar në PAMS dhe menjëherë në një raport apo raporte më vete, në rastin kur kërkohet nga Banka, të informacionit mbi gjendjen e pajtueshmërisë me PAMS-në dhe instrumentet mjedisorë dhe socialë, të përmendur aty, ku të gjitha këto raporte, në formën dhe përmbajtjen e pranueshme për Bankën, do të paraqesin, ndër të tjera: (i) gjendjen e zbatimit të PAMS-së; (ii) kushtet, nëse ka, të cilat pengojnë ose rrezikojnë të pengojnë zbatimin e PAMS-ë; dhe (iii) masat korrigjuese dhe parandaluese që janë marrë ose duhet të merren për trajtimin e këtyre kushteve; dhe

(b) Banka do të njoftohet menjëherë për çdo incident apo aksident që ka lidhje me Projektin ose ndikon tek ai, dhe që ka apo mund të ketë efekt serioz negativ mbi mjedisin, komunitetet e cenuara, publikun ose punonjësit, në përputhje me PAMS-në, instrumentet mjedisorë dhe socialë të përmendur aty dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale.

5. Huamarrësi krijon, bën publik, mban dhe vë në përdorim një mekanizëm ankimimi të aksesueshëm, me qëllim marrjen dhe mundësimin e zgjidhjes së shqetësimeve dhe ankesave të individëve tek të cilët ndikon Projekti, dhe merr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për zgjidhjen apo mundësimin e zgjidhjes së këtyre shqetësimeve dhe ankesave, në mënyrën që është e pranueshme për Bankën.

6. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale garanton se në të gjithë dokumentet e tenderit dhe kontratat për punime civile në kuadër të Projektit do të përfshihet detyrimi i kontraktuesve, nënkontraktuesve dhe subjekteve mbikëqyrëse: (a) për të respektuar aspektet përkatëse të PAMS-së dhe instrumentet mjedisorë dhe socialë të përmendur aty; dhe (b) për të miratuar dhe zbatuar kodet e sjelljes që duhet t'u sigurohen të gjithë punonjësve dhe të nënshkruhen prej tyre, dhe për të detajuar masat për trajtimin e risqeve mjedisorë dhe socialë, risqeve për shëndetin dhe sigurinë, si dhe risqeve për shfrytëzim dhe abuzim seksual, ngacmim seksual dhe dhunë ndaj fëmijëve, të gjitha këto të zbatueshme për punimet civile që porositen ose kryhen në zbatim të këtyre kontratave.

Seksioni II. <u>Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i Projektit</u>

1. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ia paraqet Bankës çdo Raport për Projektin jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik që përfshin semestrin kalendarik.

2. Përveç kur mund të kërkohet ose lejohet shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje apo përveç kur mund të kërkohet shprehimisht nga Banka, në shpërndarjen e çdo informacioni, raporti ose dokumenti për veprimtaritë që përshkruan Skeduli 1 i kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi garanton se një informacion, raport ose dokument i tillë nuk do të përfshijë të Dhëna Personale.

Seksioni III. <u>Tërheqja e të ardhurave nga Huaja</u>

A. Informacion i përgjithshëm

Pa kufizim ndaj dispozitave të Nenit II të Kushteve të Përgjithshme dhe në përputhje me Letrën për Disbursimin dhe Informacionin Financiar, Huamarrësi mund t'i tërheqë të ardhurat nga Huaja: (a) për të financuar Shpenzime të Lejueshme; dhe (b) për të paguar: (i) Tarifën Fillestare dhe (ii) çdo Normë Tavan të Interesit ose prim të Kufirit të Poshtëm të Normës së Interesit; në shumën e caktuar dhe, sipas rastit, deri në përqindjen e parashikuar përbri çdo Kategorie në tabelën e mëposhtme:

Kategoria	**Shuma e alokuar e Huasë (e shprehur në Euro)**	**Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë tatimet)**
(1) Mallra, punime, shërbime jo konsulence, shërbime konsulence, Kosto Trajnimi dhe Operative për Projektin	14,962,500	100%
(2) Tarifa Fillestare	37,500	Shuma për t'u paguar në zbatim të Seksionit 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me Seksionin 2.07 (b) të Kushteve të Përgjithshme.
(3) Norma Tavan e Interesit ose primi i Kufirit të Poshtëm të Normës së Interesit	0	Shuma e maturuar në zbatim të Seksionit 4.05 (c) të Kushteve të Përgjithshme.
SHUMA TOTALE	15,000,000	

B. Kushtet për tërheqjen; Periudha e Tërheqjes

1. Pavarësisht dispozitave të Pjesës A më sipër, nuk do të bëhet asnjë tërheqje për pagesat e kryera para Datës së Nënshkrimit, përveç që tërheqje deri në një shumë të përgjithshme që nuk e kalon shumën 6.000.000 Euro, mund të bëhen për pagesat e kryera për Shpenzime të Lejueshme para kësaj date, por jo në datën 9 mars 2020 ose pas kësaj date.

2. Data e Mbylljes është 30 qershor 2022.

SKEDULI 3

Afati i shlyerjes së amortizimit që lidhet me angazhimin

Kjo tabelë përcakton Datat e Pagesës së Principalit të Huasë dhe përqindjen e shumës totale të principalit të Huasë që duhet paguar në çdo Datë të Pagesës së Principalit ("Pjesa e Këstit").

Niveli i Shlyerjes së Principalit

Data e Pagesës së Principalit	Pjesa e Këstit
Çdo datë 1 Maj dhe 1 Nëntor Duke filluar 1 Maj, 2024 Deri më 1 Nëntor 2031	5.88%
Më 1 Maj 2032	5.92%

ANEKS

Seksioni I. <u>Përkufizime</u>

1. "Udhëzues Antikorrupsion", për qëllime të paragrafit 5 të Aneksit të Kushteve të Përgjithshme, do të thotë "Udhëzues për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në Projektet e financuara me hua nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH) dhe kredi e grante nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA)" të datës 15 tetor 2006, të rishikuar në janar 2011 dhe nga data 1 korrik 2016.

2. "Kategori" do të thotë një kategori që tregon tabela në Seksionin III.A të Skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

3. "COVID-19" do të thotë infeksion i shkaktuar nga koronavirusi i ri 2019 (SARS-CoV-2).

4. "Plani për Angazhimin Mjedisor dhe Social" ose "PAMS" do të thotë plani për angazhimin mjedisor dhe social për Projektin, i datës 15 Korrik 2020, që mund të amendohet herë pas here në përputhje me dispozitat e tij, i cili përcakton masat dhe veprimet kryesore që Huamarrësi ndërmerr ose bën që të ndërmerren me qëllim trajtimin e risqeve dhe ndikimeve mjedisorë dhe socialë të mundshëm të Projektit, duke përfshirë afatet kohore të veprimeve dhe masave, procedurat institucionale dhe atyre për plotësimin me personel, trajnimin, monitorimin dhe raportimin, si dhe çdo instrument mjedisor dhe social që duhet përgatitur në përputhje me të.

5. "Standardet Mjedisore dhe Sociale" ose "SMS", bashkërisht, do të thotë: (i) "Standardi Mjedisor dhe Social 1: Vlerësimi dhe Menaxhimi i Risqeve dhe Ndikimeve Mjedisorë dhe Socialë"; (ii) "Standardi Mjedisor dhe Social 2: Puna dhe Kushtet e Punës"; (iii) "Standardi Mjedisor dhe Social 3: Efikasiteti i Burimeve dhe Parandalimi dhe Menaxhimi i Ndotjes"; (iv) "Standardi Mjedisor dhe Social 4: Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit"; (v) "Standardi Mjedisor dhe Social 5: Blerja e Tokës, Kufizimet për Përdorimin e Tokës dhe Risistemimi i Pavullnetshëm"; (vi) "Standardi Mjedisor dhe Social 6: Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve të Gjalla Natyrore"; (vii) "Standardi Mjedisor dhe Social 7: Popujt Indigjenë/Komunitetet Tradicionale Vendase Nënsahariane Historikisht me Shërbime të Pamjaftueshme"; (viii) "Standardi Mjedisor dhe Social 8: Trashëgimia Kulturore"; (ix) "Standardi Mjedisor dhe Social 9: Ndërmjetësit Financiarë"; (x) "Standardi Mjedisor dhe Social 10: Angazhimi i Palëve të Interesuara dhe Bërja Publike e Informacionit"; kanë hyrë në fuqi në datën 1 tetor 2018, siç është publikuar nga Banka.

6. "Kushte të Përgjithshme" do të thotë "Kushte të Përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financime dhe financimin e projekteve të investimit nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH)" të datës 14 dhjetor 2018.

7. "HMIS" do të thotë sistemi i informacionit shëndetësor që ka Huamarrësi.

8. "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale" do të thotë Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale e Huamarrësit apo pasuesit të tij të pranueshëm për Bankën.

9. “Programi MPA” do të thotë programi për qasje programatike me disa faza që synon parandalimin, zbulimin dhe përgjigjen ndaj rrezikut që paraqet COVID-19, si dhe fuqizimin e sistemeve kombëtare të gatishmërisë së shëndetit publik.

10. “SHSIQSUNT” do të thotë Shërbimi i Sëmundjeve Infektive në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

11. “Kosto operative” do të thotë shpenzime të arsyeshme rritëse që kryen Huamarrësi për llogari të zbatimit të Projektit, duke përfshirë kostot lidhur me pajisjet dhe materialet e zyrave, funksionimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, kostot e transportit të dërgesave, qiratë e zyrave, kostot për komunikimin dhe sigurimet, kostot për administrimin e zyrave, shpenzimet bankare, shërbimet publike, kostot e transportit, kostot për udhëtime, dieta dhe mbikëqyrje, por duke përjashtuar pagat e punonjësve të shërbimit civil të Huamarrësit.

12. “Të dhëna personale” do të thotë çdo informacion që lidhet me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm. Individ i identifikueshëm është ai që mund të identifikohet me mjete të arsyeshme, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jo, duke iu referuar një veçorie apo kombinimi të veçorive brenda të dhënave, ose një kombinimi të të dhënave me informacione të tjera në dispozicion. Veçoritë që mund të përdoren për identifikimin e një personi të identifikueshëm përfshijnë, por pa u kufizuar vetëm në to, emrin, numrin e identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, informacionin ose emrin për adresën e postës elektronike, meta të dhënat dhe faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror të një personi.

13. “Rregullore për Prokurimin”, për qëllime të paragrafit 85 të Aneksit të Kushteve të Përgjithshme, do të thotë “Rregullore për Prokurimin e Bankës Botërore për Huamarrësit që financojnë projekte në infrastrukturë (IPF)”, të muajit korrik 2016, të rishikuar në nëntor 2017 dhe gusht 2018.

14. “Njësi për Koordinimin e Projektit” ose “NJKP” do të thotë njësia e përmendur në Seksionin 1.A. të Skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

15. “Manual Operacional i Projektit” do të thotë manuali i përmendur në Seksionin I.B.1 të Skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

16. “Datë e Nënshkrimit” do të thotë data më e vonshme e dy datave në të cilat Huamarrësi dhe Banka kanë nënshkruar këtë Marrëveshje, dhe ky përkufizim vlen për të gjithë referimet ndaj “datës së Marrëveshjes së Huasë” të Kushtet e Përgjithshme.

17. “Trajnim” do të thotë kosto të arsyeshme që lidhen me trajnimin sipas Projektit, siç kanë rënë dakord midis tyre Huamarrësi dhe Banka, dhe u ngarkohen udhëtimeve studimore, kurseve të trajnimit, seminareve, takimeve të punës dhe veprimtarive të tjera trajnuese që nuk përfshihen në kontratat e ofruesve të shërbimeve, duke përfshirë kostot për materialet e trajnimit, qiranë për hapësirën dhe pajisjet, kostot për udhëtimin, akomodimin dhe dietat e të trajnuarve dhe trajnuesve, tarifat e trajnuesve dhe shpenzime të tjera të ndryshme që lidhen me trajnimin.